

UDHËRRËFYES

për komunitete energjetike me të drejta
shoqërore dhe gjinore në Shqipëri



© Milieukontakt Shqipëri
Tetor 2025

Autorët: Valbona MAZREKU dhe Arion SAUKU - **Milieukontakt Shqipëri**
Katharina HABERSBRUNNER dhe Johannes BAUMANN - **WECF e.V.**

Dizenjuar:



Ky dokument është prodhuar në kuadër të projektit “Komunitete energjetike me të drejta shoqërore dhe gjinore në Shqipëri”, i mbështetur financiarisht nga Fondacioni Federal Gjerman për Mjedisin (DBU) dhe bashkëfinancuar EWS. Opinione të paraqitura në këtë dokument janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit Federal Gjerman për Mjedisin (DBU) ose EWS.

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



RRETH PROJEKTIT

Ky projekt synon të promovojë energjitë e rinovueshme në Shqipëri, të inkurajojë pjesëmarrjen e qytetarëve në tranzicionin energjetik dhe njëkohësisht të forcojë barazinë gjinore. Në mënyrë specifike, gratë sipërmarrëse shqiptare në zonat rurale, familjet me të ardhura të ulëta dhe të rinjtë do të mësojnë të njohin dhe të kuptojnë potencialin e energjisë komunitare, si dhe vetë-konsumimin dhe vetë-prodhimin e energjisë së rinovueshme. Këto grupe të shoqërisë duhet të motivohen dhe fuqizohen për t'u angazhuar gjerësisht.

Kontaktet:

WECF e.V.

St.-Jakobsplatz 10, 80331 München, Gjermani

www.wecf.org

Milieukontakt Shqipëri

Sheshi Avni Rustemi, P. Teuta Konstruktion, Shqipëri

www.milieukontakt.org

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	7
PJESA 1 PËRMIRËSIMI I KUADRIT DHE KONTEKSTIT PËR KOMUNITETET ENERGJETIKE	
1.1 Veprim për kornizat ligjore dhe politikat	10
1.2 Veprim për realizimin teknik dhe administrativ	11
1.3 Veprime për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për informimin	13
1.4 Veprim për mundësitë financiare	14
PJESA 2 KRIJIMI I NJË KOMUNITETI ENERGJIE TË DREJTË NGA ANA SHOQËRORE DHE GJINORE NË SHQIPËRI	
1. IDEJA DHE PËRKUFIZIMI I NJË KOMUNITETI ENERGJIE	18
2 ANALIZA E GJENDJES FILLESTARE	19
3. PLANIFIKIMI I NJË KOOPERATIVE ENERGJETIKE ME DREJTËSI GJINORE	
3.1 Grupi themelues si ekip qendror	25
3.2 Ndërgjegjësimi i komunitetit dhe formimi i grupit	25
3.3 Përcaktimi i vizionit, misionit dhe vlerave	26
3.4 Partnerët e mundshëm	27
3.5 Larmia dhe përfshirja	28
3.6 Teknologjitë e mundshme	30
3.7 Zhvillimi i modelit dhe planit të biznesit	32
3.8 Skicimi i komunitetit energjetik	35
3.9 Të kuptuarit e kuadrit ligjor në Shqipëri	36
3.10 Themelimi i kooperativës dhe hartimi i statutit	37
4. STRATEGJITË E FINANCIMIT DHE MBËSHTETJES	38
5. PLANIFIKIMI TEKNIK DHE ZBATIMI	41
6. ANGAZHIMI I KOMUNITETIT DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE	44
7. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE ZGJERIMI	46

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Thelbi i një Komuniteti Energjetik	19
Figura 2: Analiza politike, ekonomike, shoqërore dhe teknologjike e kontekstit shqiptar për Komunitetet e Energjisë	20
Figura 3: Shembull i vizionit dhe misionit të një komuniteti energjie	26
Figura 4: Shembull i grupeve të mundshme të interesit në një bashkësi energjie	28
Figura 5: Potenciali i energjisë fotovoltaike në Shqipëri	31
Figura 6: Skicimi i një modeli sipërmarrjeje me Trekëndëshin Magjik	33
Figura 7: Shembull i një modeli sipërmarrjeje për një bashkësi energjie mbështetur në metodën e trekëndëshit magjik	34
Figura 8: Tre kriteret më të rëndësishme për përzgjedhjen e vendit të prodhimit	41

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Shembull i një Plani Veprimi për të garantuar përfshirje në mënyrësistematike	29
Tabela 2: Forma të ndryshme ligjore si opsion për Komunitetet e Energjisë	35
Tabela 3: Vështrim i përgjithshëm i subvencioneve/mbështetjes të qeverisë Shqiptare	40
Tabela 4: Mundësitë e financimit për komunitetet e energjisë në Shqipëri dhe donatorët ndërkombëtarë	40



HYRJE


Ky udhërrëfyes paraqet një udhëzim të plotë dhe praktik për krijimin e komuniteteve energjetike gjithëpërfshirëse dhe me të drejta gjinore në Shqipëri.

I mbështetur në zhvillimet më të fundit ligjore, shoqërore dhe ekonomike, ai i përgjigjet drejtpërdrejt strukturës në ndryshim të energjisë në vend, ku krahas mundësive të reja për pjesëmarrjen e komuniteteve në energjinë e rinovueshme, po shfaqen dhe sfida të mëdha. Duke ndërthurur rekomandime strategjike me metoda praktike, dokumenti fuqizon qytetarët, bashkitë, OJF-të dhe politikëbërësit për të ndërtuar nisma energjie të rinovueshme të drejtuara nga komuniteti, të cilat janë si elastike dhe shoqërisht të ekuilibruara.

Udhërrëfyesi është i organizuar në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë fokusohet në forcimin e mjedisit mundësues për komunitetet energjetike në Shqipëri. Ajo jep një analizë të plotë të kornizës aktuale duke nxjerrë në pah paqartësitë ligjore, pengesat teknike dhe administrative, kufizimet financiare dhe zbrazëtitë në ndërgjegjësimin publik. Duke u mbështetur në modele të provuara dhe praktika më të mira ndërkombëtare, kjo pjesë paraqet hapa konkrete e të zbatueshme, identifikon aktorët përgjegjës dhe përcakton afate dhe rezultate të qarta. Planet e veprimit përgjatë kësaj pjese sigurojnë që çdo rekomandim të jetë praktik dhe i përshtatur me realitetin e sektorit energjetik shqiptar.


Pjesa e dytë përkthen këto objektiva strategjike në një udhëzues hap pas hapi për themelimin dhe funksionimin e një komuniteti energjetik në kontekstin e sotëm shqiptar. Ajo nis me mjete për analizimin e nevojave lokale, ngritjen e ekipit themelues dhe përcaktimin e një vizioni dhe misioni përfshirës. Kjo pjesë shtjellon se si të zgjidhet forma e duhur ligjore, të organizohet struktura bashkëpunuese, të sigurohen burime të ndryshme financimi dhe të vihen në jetë zgjidhje teknike të qëndrueshme gjithmonë me theks të fortë te larmia, drejtësia gjinore dhe pjesëmarrja e gjerë komunitare. Aty trajtohen gjithashtu partneritetet, forcimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmëria afatgjatë, duke ofruar një model praktik që mund të përsëritet dhe përshtatet në rajone të ndryshme të Shqipërisë.

Në tërësi, ky udhërrëfyes shërben si frymëzim dhe udhëzim për ata që duan të ndikojnë në tranzicionin e energjisë së pastër në Shqipëri duke garantuar që procesi të jetë i qëndrueshëm, i orientuar për nga komuniteti dhe pa lënë askënd pas.



PJESA 1

PËRMIRËSIMI I KUADRIT DHE KONTEKSTIT PËR KOMUNITETET ENERGJETIKE



1.1 VEPRIM PËR KORNIZAT LIGJORE DHE POLITIKAT

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Mjedisi ligjor për energjinë e rinovueshme në Shqipëri ka bërë hapa të rëndësishëm drejt përafrimit me Direktivën e BE-së për Energjinë e Rinovueshme (RED II), sidomos pas miratimit të ligjit “Për energjinë e rinovueshme” në vitin 2023. Megjithatë, aktet nënligjore që janë thelbësore për vënien në punë të veprimtarive të prodhues-përdoruesve dhe komuniteteve energjetike mbeten të pazhvilluara. Kjo krijon paqartësi ligjore në fusha kyçe si regjistrimi i komuniteteve energjetike, kompensimi për energjinë e tepërt dhe procedura të lehtësuara për lejet. Mungesa e një kuadri të qartë për vetë-konsumatorët dhe komunitetet energjetike shkurajon angazhimin qytetar dhe kufizon përdorimin e zgjidhjeve për energjisë e rinovueshme.

HAPAT PËR TË ECUR PËRPARA

Për shfaqjen e kooperativave energjetike, një hap i parë thelbësor është advokimi për miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore gjithëpërfshirëse, duke përfshirë rregulla për faturimin neto, kërkesa teknike dhe mekanizma për shitjen e energjisë elektrike. Angazhimi me institucione kyçe si Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) është thelbësor për të komunikuar nevojat e posaçme të projekteve energjetike komunitare. Njëherazi dhe si hap i dytë, bashkëpunimi me bashkitë për hartimin e rregulloreve model për kooperativat energjetike mund të krijojë kuadër të përsëritshëm lokal dhe të vendosë precedentë për zhvillimin e energjisë së rinovueshme të drejtuar nga vetë komuniteti.

Integrimi i Shqipërisë në strukturat evropiane, duke përfshirë procesin e anëtarësimit në BE, ofron mundësi për të përfituar nga praktikat më të mira dhe për t'u lidhur me rrjete mbështetëse si Rescoop.eu dhe rrjete e organizata të ngjashme. Këto partneritete mund të ofrojnë modele për struktura ligjore të suksesshme, udhëzime për qeverisjen bashkëpunuese dhe mundësi për njohjen e nismave shqiptare në arenën evropiane.

PLANI I VEPRIMIT PËR VËNIEN NË JETË

Veprimi	Përgjegjësi	Afati	Ndikimi i pritur
Organizim i këshillimeve të përbashkëta me ERE dhe MIE për boshllëqet në aktet nënligjore	Komuniteti i mundshëm energjetik, juristë, OJF	6 muaj	Rrugëtim i qartë për reforma ligjore në favor të komuniteteve energjetike
Hartimi i rregulloreve model për kooperativat lokale të energjisë	Komuniteti i mundshëm energjetik, këshilltarë ligjorë, bashki	9–12 muaj	Ofron struktura konkrete e të përsëritshme ligjore për projektet energjetike në komunitet
Paraqitje propozimesh në institucionet kombëtare për ndryshime në ligje dhe akte nënligjore	Komuniteti i mundshëm energjetik, me mbështetjen e bashkive	12 muaj	Nxit miratimin e kuadrit ligjor mbështetës
Angazhim me rrjetet e BE-së (psh. Rescoop.eu) për shkëmbim njohurish	Komuniteti i mundshëm energjetik, OJF	Vijues	Qasje në praktikat më të mira dhe rrit dukshmërinë e veprimeve në Shqipëri

1.2 VEPRIM PËR REALIZIMIN TEKNIK DHE ADMINISTRATIV

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Infrastruktura e rrjetit elektrik në Shqipëri, e projektuar kryesisht për sisteme të qendëruara hidroenergjetike, has sfida në integrimin e burimeve të shpërndara të energjisë së rinovueshme. Proceset e lejeve janë të gjata, të ndërlikuara dhe jotransparente, çka shkurajon prodhues-përdoruesit dhe komunitetet potenciale energjetike në ndjekjen e projekteve. Kërkesat teknike për lidhjen në rrjet janë ende të paqarta, teknologji për rrjete inteligjente si matësit e zgjuar apo sistemet e monitorimit në kohë reale, që janë thelbësore për administrimin e decentralizuar të energjisë, gjejnë përdorim të ulët.

HAPAT PËR TË ECUR PËRPARA

Hapi i parë është angazhimi me OSHEE (operatorin eshpërndarjes) dhe ERE për të thjeshtuar proceset e lidhjes në rrjet, veçanërisht për projektet e vogla që prihen nga komuniteti. Caktimi i kriterëve të qarta teknike, procedurave të përsheptuara dhe një pike të dedikuar kontakti për zhvilluesit e projekteve do të ulë ndjeshëm barrierat administrative. Si hap i dytë, projektet pilot mund të shërbejnë si terren testimi për procedura të thjeshtuara dhe zgjidhje teknike novatore.

Njëherazi, nxitja e bashkëpunimeve me universitete, ekspertë teknikë dhe sektorin privat do të prodhojë kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin me sukses të projekteve. Këto bashkëpunime mund të krijojnë modele të shkallëzueshme për integrimin në rrjet të energjisë së gjeneruar nga komunitetet dhe përgatitjen e terrenit për adoptim më të gjerë.

PLANI I VEPRIMIT PËR VËNIEN NË JETË

Veprimi	Përgjegjësi	Afati	Ndikimi i pritur
Nisja e diskutimeve me OSHEE dhe ERE për kriterë të qarta për lidhjen në rrjet të prodhues përdoruesve	Komuniteti i mundshëm energjetik, ekspertë teknikë	6–9 muaj	Ul vonesat dhe sqaron kërkesat teknike
Krijimi i projekteve pilot për të testuar procedurat dhe teknologjitë e thjeshtuara	Komuniteti i mundshëm energjetik, universitete, OSHEE	12 muaj	Shfaq realizueshmërinë teknike dhe rrit besimin
Bashkëpunim me partnerë në teknologji për vënie në punë të zgjidhjeve të rrjeteve inteligjente	Komuniteti i mundshëm energjetik, ofrues teknologjie	18 muaj	Përmirëson fleksibilitetin dhe efektshmërinë e rrjetit
Propozim dhe përkrahje për një zyrë të centralizuar për mbështetje të lidhjeve në rrjet	Komuniteti i mundshëm energjetik, bashki, OSHEE	12 muaj	Thjeshton procedurat dhe rrit transparencën

1.3 VEPRIME PËR RRITJEN E NDËRGJEGJËSIMIT DHE PËR INFORMIMIN

HAPAT PËR TË ECUR PËRPARA

Një pengesë kryesore për ngritjen e kooperativave energjetike në Shqipëri është mungesa e ndërgjegjësimit publik për përfitimet sociale, ekonomike dhe mjedisore nga energjia e rinovueshme e bazuar në komunitet. Gjithashtu, vërehet një asociim i mbetur i termit “kooperativë” me modele ekonomike të prapambetura nga e kaluara socialiste, që shpesh risjellin mosbesim. Kapërcimi i këtyre perceptimeve kërkon fushata proaktive informimi, shembuj të suksesshëm dhe një mjedis ku energjia e rinovueshme shihet si pasuri e përbashkët komunitare.

Si hap i parë, krijimi i një qendre informacioni për komunitetet energjetike si online ashtu dhe fizike mund të ofrojë burime të aksesueshme, duke përfshirë udhëzues, modele dokumentesh dhe informacione për mundësitë e financimit. Së dyti, projektet “fanar” (lighthouse), edhe në shkallë të vogël, janë thelbësore për të ndërtuar besim dhe për të shfaqur përfitimet praktike nga energjia komunitare. Një hap i tretë do të ishin nismat edukuese, workshopet dhe partneritetet me shkolla e organizata lokale për të ndihmuar në integrimin e konceptit të kooperativave energjetike në strukturën shoqërore, duke krijuar mbështetje të gjerë.

PLANI I VEPRIMIT PËR VËNIEN NË JETË

Veprimi	Përgjegjësi	Afati	Ndikimi i pritur
Nisja e një projekti pilot që shfaq përfitimet nga kooperativat energjetike	Kooperativa e mundshme energjetike me mbështetjen e bashkive	12–18 muaj	Ndërton besim publik dhe krijon shembuj të përsëritshëm suksesi
Krijimi i një qendre informacioni (online dhe fizike) me burime të qarta dhe të arritshme	MIE, OJF, institucione arsimore	9–12 muaj	Rrit njohuritë dhe fuqizon pjesëmarrjen qytetare
Organizimi i punëtorive, programeve shkollore dhe fushatave mediatike	MIE, OJF, arsimtarë, media	Vijimisht	Zgjeron ndërgjegjësimin publik dhe ngre një lëvizje mbështetëse

1.4 VEPRIM PËR MUNDËSITË FINANCIARE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Qëndrueshmëria financiare është faktor vendimtar për suksesin e kooperativave energjetike në Shqipëri. Kostot e larta fillestare për instalimet e energjisë së përtëritshme, si dhe mungesa e skemave të kompensimit për energjinë e tepërt, shkurajojnë pjesëmarrjen. Megjithatë, integrimi i Shqipërisë në BE dhe qasja në programe rajonale financimi ofrojnë mundësi të pashoqe për financimin fillestar të projekteve. Ndërtimi i kapaciteteve, grantet mbështetëse dhe modelet e financimit të përzier (publike e private) mund të bëjnë që projektet energjetike bashkëpunuese të jenë më të arritshme dhe tërheqëse.

HAPAT PËR TË ECUR PËRPARA

Fillimisht, duhet ndjekur një qasje strategjike që përfshin kërkimin aktiv të fondeve të BE dhe ato rajonale për projektet pilot, bashkëpunimin me bashkitë për bashkëfinancim dhe përdorim të tokës, si dhe angazhimin e institucioneve financiare vendore për kredi ose modele hibride financimi. Së dyti, nisja e fushatave lokale të mbledhjes së fondeve, duke përfshirë bonot komunitare ose financime nga publiku, mund të fuqizojë qytetarët të investojnë drejtpërdrejt dhe të përfitojnë nga projektet energjetike komunitare. Këto hapa jo vetëm mobilizojnë burime, por thellojnë dhe pronësinë vendore dhe angazhimin lokal.

PLANI I VEPRIMIT PËR VËNIEN NË JETË

Veprimi	Përgjegjësi	Afati	Ndikimi i pritur
Aplikim për fonde të BE-së dhe rajonale për projektet pilot të kooperativave	Komuniteti i mundshëm energjetik, OJF, bashki	12 muaj	Siguron kapitalin fillestar thelbësor
Bashkëpunim me bashkitë për bashkëfinancim, qira toke dhe mbështetje politike	Komuniteti i mundshëm energjetik, drejtues bashkiakë	9 muaj	Ul kostot dhe krijon kuadër lokal mbështetës
Partneritet me banka lokale dhe investitorë për financim hibrid	Komuniteti i mundshëm energjetik, institucione financiare	8 muaj	Shumëfishon mundësitë për financim dhe rrit besimin e aktorëve financiarë
Nisja e nismave vendore për financim komunitar (kuota anëtarësie, financim nga publiku)	Komuniteti i mundshëm energjetik, organizata vendore	12 muaj	Thellon përfshirjen lokale, siguron pronësi komunitare të projektit

PJESA 2

KRIJIMI I NJË KOMUNITETI ENERGJIE TË DREJTË NGA ANA SHOQËRORE DHE GJINORE NË SHQIPËRI





1 IDEJA DHE PËRKUFIZIMI I NJË KOMUNITETI ENERGJIE

Gjithçka nis me një ide dhe me vullnetin për të vepruar nuk ka rëndësi ku jeton në Shqipëri. Pavarësisht nëse jeton në një apartament në Tiranë apo administron një bujtinë të vogël në Përmet, arsyet për të nisur një komunitet energjie shpesh lindin nga bisedat e përditshme, shqetësime të thjeshta dhe shpresa të përbashkëta:

- *Disa prej nesh duan të bëjnë diçka konkrete, jo vetëm të flasin për ndryshimet klimatike. Vendosja e paneleve diellore në çati duket si një hap i vërtetë drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.*
- *Të tjerë mendojnë praktikisht dhe duan të investojnë në diçka lokale, të dobishme dhe të prekshme.*
- *Të jesh më i pavarur nga çmimet e paqëndrueshme të energjisë duke prodhuar energjinë tënde, duke ndihmuar njëri-tjetrin dhe duke kursyer së bashku.*
- *Të mbledhësh shuma të vogla parash nga rrjeti, familja dhe fqinjët për t'i mbajtur vlerat brenda rajonit: duke investuar në impiante fotovoltaike për komunitetin energjetik, vlera mbetet në zonë, mbështet biznese të tjera lokale dhe forcon zhvillimin rajonal.*
- *Dhe, në fund, është ndjesi e mirë të thuash: "Po, unë ndihmova në ndërtimin e kësaj. Ky impiant fotovoltaike është pjesërisht i imi."*

Kështu fillon një komunitet energjie, thjesht me njerëz që bashkohen, ndajnë një vizion dhe një qëllim, dhe ndërmarrin hapa për ta vënë atë në jetë.

Por si funksionon një komunitet energjie?

Në terma të përgjithshëm, një komunitet energjie është një grup njerëzish që bashkohen për të planifikuar, investuar dhe administruar projekte energjie të pastër. Ata kujdesen për planifikimin teknik dhe ekonomik, mbikëqyrin instalimin e teknologjive dhe sigurojnë që çdo fitim a kursim të kthehet përsëri në komunitet, duke mbështetur nevoja lokale dhe krijuar vlera afatgjata për të gjithë pjesëmarrësit.

Figura më poshtë ilustron këtë koncept:




Figura 1: Thelbi i një Komuniteti Energjetik
Burimi: Krijuar nga autorët

2 ANALIZA E GJENDJES FILLESTARE

Përpara se të filloni një komunitet energjie në Shqipëri, është thelbësore të kuptohet konteksti rajonal dhe të identifikohen faktorët nxitës dhe pengesat për themelimin e tij të suksesshëm. Kjo analizë mund të kryhet më së miri përmes të ashtuquajturës “analizë PEST”, e cila shqyrton faktorët politikë, ekonomikë, shoqërorë dhe teknologjikë që ndikojnë në zhvillim. Këto faktorë paraqiten në Figura 2 dhe shpjegohen më poshtë.

SHTYTËSIT

ASPEKTET POLITIKE

- Shqipëria me ligjin nr 24/2023 ka adoptuar kuadrin ligjor për komunitetet e energjisë

ASPEKTET EKONOMIKE

- Ligji nr 24/2023 prezanton skema mbështetëse (si tarifat e garantuara pagesat premium për projektet në shkallë të vogël).

ASPEKTET SOCIALE

- Njerëzit dëgjojnë mbi suksesin e komuniteteve të energjisë në vende të tjera dhe bëhen kuriozë

- Dëshirë për të forcuar komunitetet e energjisë ndërsa krijojnë ndikim pozitiv në aspektet sociale, mjedisore dhe ekonomike.

ASPEKTET TEKNOLOGJIKE

- Sistemet FV janë kosto efektive dhe teknologjikisht të provuar

Barrierat

- Aktet nënligjore mungojnë duke krijuar një kuadër rregullator jo të qartë;

- Procedura të gjata kohore për regjistrimin e sistemeve FV dhe lidhjen me rrjetin (procedura aplikimi të komplikuar, pasiguria e miratimit)

- Mungesa e strategjisë kombëtare të komuniteteve të energjisë (mungesa e targeteve kombëtare për projekte)

- Mungesa e mbështetjes politike nga përfaqësuesit vendor

- Mungesa e rregullave dhe e metodologjisë të qartë për mbiprodhimin e energjisë së gjeneruar nga paneli

- Deri më tani mbi prodhimi nuk është kompensuar;

- Marrëveshje publike private jo të standartizuara dhe pamundësi për palë të treta për të marrë kontrata

- Mundësi financimi të kufizuara (grante, kredi)

- Incentiva të pamjaftueshme për projekte të ngrohjes së rinovueshme: zëvendësimi i ngrohësve me karburant me boiler me biomasë, me panel solar, pompa të nxehtësisë.

- Përgjithësisht nuk ka incentiva financiare për projektet e energjisë së rinovueshme.

- Nuk ka ende shembull "fanar" komuniteti të energjisë së rinovueshme në Shqipëri;

- Hezitues përse i takon burokracisë dhe rregullave të paqarta;

- Mungesë informacioni për komunitetet e energjisë

- Përgjithësisht besim i ulët tek "modeli i kooperativës" për shkak të së kaluarës.

- Rrjeti i energjisë në Shqipëri nuk është në kushte optimale duke krijuar barriera në planin afatgjatë të zhvillimit të komuniteteve të energjisë;

- Mungesë e ekspertëve teknikë me njohuri mbi hartimin, planifikimin, prokurimin dhe zbatimin e projektit

Figura 2: Analiza politike, ekonomike, shoqërore dhe teknologjike e kontekstit shqiptar për Komunitetet e Energjisë.

ASPEKTI POLITIK

Siç u shtjellua në seksionin 1.1 "Veprim për kornizën ligjore dhe politikat", Shqipëria ka ndërmarrë një hap me rëndësi me miratimin e ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e burimeve të energjisë së rinovueshme", i cili për herë të parë njeh ligjërisht komunitetet energjetike.

Megjithatë, pjesa dytësore e legjislacionit që kërkohet për të vënë në punë ligjin që përcakton mënyrën e regjistrimit, njohjen ligjore dhe të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve energjetike ende mungon. Kjo zbrazëti krijon pasiguri ligjore dhe pengon nismat e reja.

Pavarësisht këtyre sfidave, kërkimi ynë sugjeron një rrugë konstruktive: bashkëpunimi i ngushtë me bashkitë dhe ekspertët ligjorë mund të krijojë precedent dhe të zhvillojë modele ligjore konkrete. Këta shembuj mund të shërbenin si modele për projekte të ardhshme komunitetesh energjie, të ndihmojë në mbushjen e zbrazëtive ligjore dhe të zgjerojë vënien në jetë në rang kombëtar.

Çështjet që duhen trajtuar për njohjen ligjore përfshijnë:

- **Subjekti ligjor** – zgjidh një formë juridike që ka mjaft gjasa të lejohet për komunitete energjie
- **Aktivitetet** – përcakto veprimtaritë që do të ndërmarrë komuniteti (psh. prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike të tepërt)
- **Afërsia gjeografike** – përcakto zonën ku do të veprojë komuniteti duke pasur parasysh kontekstin vendor dhe teknologjitë që do të përdoren
- **Kontrolli efektiv** – cakto kushte pranimi për anëtarët që mund të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen; Përcakto autonominë dhe identifikoj standardet përkatëse
- **Qëllimi kryesor** – sqaro se çfarë nënkupton të kesh një qëllim kryesor përveç fitimit financiar dhe identifikoj standardet përkatëse
- **Përfitimet sociale, ekonomike dhe mjedisore** – përcakto se çfarë quhet përfitim shoqëror, ekonomik dhe mjedisor për për zonën ku vepron

ASPEKTI EKONOMIK

Edhe pse qeveria shqiptare ka futur mekanizma mbështetës si tarifatat e garantuara (feed-in tariffs) për projektet e vogla të energjisë së rinovueshme, mungesa e një skeme nxitjeje nuk u jep mundësi komuniteteve të energjisë ngaqë këto instrumente financiare janë thelbësore për të ngritur modele sipërmarrjeje dhe për të nxitur investime në teknologji të përtëritshme. Gjithsesi, pengesë serioze mbetet mostrajtimi i duhur i energjisë së tepërt.

Aktualisht, energjia e tepërt që derdhet në rrjet nga prodhuesit privatë i kalon Furnizuesit të Shërbimit Universal pa ndonjë kompensim financiar. Kjo e bën të vështirë që komunitetet energjetike të mbeten ekonomikisht të qëndrueshme sepse ato duhet të nxjerrin të ardhura jo vetëm për të siguruar qëndrueshmërinë por dhe për të riinvestuar në projekte të ardhshme energjie të përtëritshme dhe në infrastrukturë.

Siç u përmend në seksionin 1.4 “Veprime për mundësitë financiare”, mungesa e modelit të qëndrueshëm të biznesit kufizon dhe qasjen në kredi apo financime të tjera, sidomos për zonat rurale dhe familjet ku qasja të kapitali mbetet e kufizuar. Në këtë kontekst, identifikimi dhe mobilizimi i instrumenteve alternative të financimit, si për shembull kombinimi i fondeve të BE-së dhe atyre rajonale, bashkëfinancimi nga bashkitë dhe përdorimi i tokave publike mund të jenë rrugë të mundshme.

ASPEKTI SOCIAL

*Ideja e komuniteteve energjetike përputhet me vlerat e shumë qytetarëve shqiptarë, sidomos në zonat e vogla ose rurale ku lidhjet komunitare janë ende të forta. Ka interes për të marrë pjesë në projekte që sjellin përfitime mjedisore dhe sociale, ulje të kostove të energjisë, rritje të pavarësisë energjetike dhe bashkëpunim mes fqinjëve. Megjithatë, modeli i energjisë së përbashkët që drejtohet demokratikisht nga komuniteti është ende koncept i ri. Parime si **pronësia kolektive, vendimmarrja e përbashkët dhe kontrolli nga bashkësia duhet të kuptohen dhe të shpjegohen më qartë.** Nëse aspektet e lartpërmendura të qeverisjes (siguria juridike, shpërblimi për energjinë e prodhuar/tarifat e garantuara etj.) nuk përcaktohen qartë dhe nuk mbështeten nga strukturat ligjore, pjesëmarrja mund të mbetet e kufizuar në pak individë dhe të mos arrijë angazhim të gjerë të bashkësisë.*

Në disa raste mund të ketë dhe pengesa gjinore për shembull, burrat mund të merren më shumë me çështje teknike apo financiare, ndërsa gratë mund të kenë më pak kohë për pjesëmarrje për shkak të përgjegjësiave familjare apo mungesës së trajnimit teknik ose dhe të ketë më pak gra me trajnim teknik.

ASPEKTI TEKNOLOGJIK

Shqipëria ka potencial shumë të mirë diellor, kostot e teknologjisë FV po bien, por integrimi i tyre në rrjetet lokale është ende i ndërlikuar për arsye teknike dhe administrative. Veç këtyre, rrjeti energjetik kombëtar, sidomos në zonat rurale, është i vjetëruar dhe shpesh nuk mund të përballojë prodhimin e shpërndarë nga burimet e rinovueshme.


Një përshkrim më i detajuar për mënyrën e trajtimit të kësaj çështjeje jepet në seksionin për “Zgjedhjen e vendndodhjes dhe projektimin e prodhimit të energjisë”.

Në përmbledhje, analiza PEST ju ndihmon të kuptoni faktorët politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë, si dhe pengesat që ndikojnë në zhvillimin e një komuniteti energjie të drejtë nga pikëpamja gjinore dhe shoqërore. Duke i identifikuar që në krye, ju mund të parashikoni pengesat dhe t'i trajtoni ato me strategji të posaçme para se të nisë zbatimin e projektit.

Një strategji e efektshme është që t'ia nisësh në shkallë të vogël, psh. me një projekt pilot për disa shtëpi. Kjo qasje shfaq sukses të prekshëm, ngre besimin në bashkësi dhe tërheq fonde të tjera për zgjerim në të ardhmen. Rezultatet e përftuara shpesh rrisin besimin te financuesit dhe grupet e interesit duke trajtuar drejtpërdrejt sfidat që burojnë nga burimet e kufizuara financiare.

Tjetër strategji me rëndësi është **përfshirja që herët e autoriteteve vendore**. Duke informuar bashkinë dhe kërkuar mbështetjen e saj, pakësoni pengesat politike dhe administrative. Bashkëpunimi i hershëm nxit mbështetjen dhe mund të zbusë më vonë proceset rregullatore.

Për më tepër, të nxënit nga të tjera organizata që kanë zbatuar projekte të ngjashme mund të vlejë shumë. Këto grupe mund të ndajnë modele dokumentesh, të mbështesin në përmbushjen e kërkesave ligjore (psh., lidhja me rrjetin, marrja e licensës për prodhim). Kjo mbështetje mes kolegësh mund të shkurtojë kohë, të ulë përpjekjet dhe të ndihmojë në përmbushjen më të efektshme të proceseve burokratike.



Çdo arritje ligjore (si licenca e prodhimit apo lidhja me rrjetin) forcon besueshmërinë e komunitetit tuaj dhe hap rrugën për politika edhe më mbështetëse në të ardhmen. Në terma afatgjatë, përvoja juaj mund të ndihmojë në përmirësimin e mëtejshëm të rregulloreve dhe në forcimin e rolit të qytetarëve në tranzicionin energjetik të Shqipërisë.

Në përgjithësi, Shqipëria po ecën drejt standardeve të BE-së për energjinë, që do të thotë më shumë fuqizim komunitar, jo më pak. Komuniteti juaj energjetik është pjesë e kësaj vale të re dhe ndonëse mund të hasni disa vështirësi burokratike, tashmë keni bazën ligjore dhe mbështetjen politike për ta bërë këtë proces më të lehtë se disa vite më parë.

3. PLANIFIKIMI I NJË KOOPERATIVE ENERGJETIKE ME DREJTËSI GJINORE

3.1 GRUPI THEMELUES SI EKIP QENDROR

Hapi i parë për formimin e një grupi themelues është identifikimi i anëtarëve potencialë përmes kontakteve dhe rrjeteve bashkëpunuese. Grupi themelues duhet të përbëhet nga individë të përkushtuar ndaj vizionit dhe objektivave të komuniteteve energjetike me drejtësi gjinore. Atyre u duhen aftësi dhe njohuri të nevojshme për të kuptuar funksionimin e kooperativës dhe për të përmbushur detyrat që lidhen me ngritjen dhe menaxhimin e saj.

Për këtë arsye, është mirë që grupi të përfshijë individë me aftësi dhe përvoja të ndryshme, si ekspertizë teknike, administrim projektesh, financa, dhe qasje të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore.

3.2 NDËRGJEGJËSIMI I KOMUNITETIT DHE FORMIMI I GRUPIT

Hapi i radhës është organizimi i një takimi në komunitet për të diskutuar krijimin e Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme (REC) dhe për të vlerësuar interesin e mundshëm. Në këtë takim duhet të ketë një paraqitje të përfitimeve nga REC, ideja e biznesit, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të përfshirë, si dhe hapat e ardhshëm.

Shpjegoni përfitimet e një komuniteti energjie në mënyrë të thjeshtë, për shembull, uljen e faturave të energjisë dhe kontrollin lokal mbi furnizimin me energji. Ilustroni me shembuj konkretë, psh., si një sistem panelesh diellore mund të furnizojë me energji shtëpitë lokale, ose mënyrën se si funksionon një kooperativë.

Diskutoni nevojat e komunitetit (psh. furnizim i qëndrueshëm me energji për shtëpi, shkolla, sipërmarrje) dhe dëgjoni idetë që shfaqen. Ky takim fillestar duhet gjithashtu që tu japë njerëzve mundësinë të shtrojnë pyetje, të shprehin shqetësimet e tyre, duke siguruar transparencë që në fillim.

Sigurohuni që grupi të ketë larmi, ftoni në mënyrë aktive gra, të rinj, të moshuar, familje në nevojë a të tjerë që zakonisht mbeten jashtë përfshirjes. Qëllimi i këtij hapi është të rritet ndërgjegjësimi dhe të krijohet një bërthamë e angazhuar anëtarësh nga komuniteti që do të çojnë projektin përpara.

3.3 PËRCAKTIMI I VIZIONIT, MISIONIT DHE VLERAVE

Organizoni një takim planifikimi me grupin themelues për të hartuar vizionin dhe misionin e REC-ut, si dhe për t'u dakordësuar mbi vlerat dhe objektivat kryesore. Kjo është një seancë e thelluar ku grupi përmirëson idetë që janë projektuar në fazën e mëparshme të "Idesë". Filloni duke mbledhur një grup të larmishëm anëtarësh të interesuar nga komuniteti (duke përfshirë gra dhe të rinj) për të diskutuar pse dëshironi të krijoni një komunitet energjie. Së bashku, hartoni një vizion dhe mision të qartë për komunitetin tuaj të energjisë së përtëritshme, duke përvijuar qëllimin, objektivat afatgjata dhe vlerat që do ta udhëheqin. Sigurohuni që në këto deklaratë të përfshihen qartazi barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Figura e mëposhtme ilustron një shembull të një vizioni dhe misioni:




Figura 3: Shembull i vizionit dhe misionit të një komuniteti energjie

Ofrimi i energjisë elektrike të përballeshme nga instalimet fotovoltaike për zhvillimin e qëndrueshëm përmes kooperativës të krijuar dhe drejtuar nga të gjithë anëtarët duke siguruar pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave.

Diskutoni me grupin vizionin dhe misionin e REC, çfarë synoni të arrini. Pasi të keni diskutuar deklaratat e vizionit/misionit, ndajeni misionin në objektiva të posaçme të matshme. Objektivat mund të përfshijnë: sasinë e energjisë së përtëritshme që do të prodhohet (psh. një sistem panelesh diellore prej 10–20 kWp), numrin e familjeve që do të lidhen, uljen e faturimit të energjisë me një përqindje të caktuar, ose trajnimin e një numri të caktuar grash dhe burrash në role teknike dhe drejtuese. Këto objektiva do ta udhëheqin planifikimin dhe do të ndihmojnë në ndjekjen e përparimit.

Në këtë fazë, filloni të identifikoni detyrat kryesore që nevojiten për të nisur REC-un. Për shembull, rendisni gjëra si: kryerja e një ankete për konsumin e energjisë elektrike në komunitet, kërkimi i furnitorëve të paneleve diellore, verifikimi i hapave ligjore të regjistrimit etj., në thelb një listë paraprake detyrash. Sipas udhëzuesve të komuniteteve energjetike, kjo është dhe një kohë e mirë për të përgatitur një vijë kohore paraprake dhe, ndoshta, për të formuar grupe pune të vogla për detyra të caktuara. Në fund të këtij hapi, sekush duhet të ketë kuptuar qartë qëllimin e REC dhe roleve të tyre në procesin e ardhshëm.

3.4 PARTNERËT E MUNDSHËM

Mos e bëni të gjithë punën vetëm, pasi partneritetet mund të rrisin ndjeshëm shanset për sukses. Kontaktoni me aktorë kyç që mund të mbështesin ose këshillojnë REC-un tuaj. Këta mund të jenë organe të qeverisjes vendore (zyra bashkiake për energjinë ose mjedisin), agjenci kombëtare si Agjencia e Efiçencës së Energjisë, OJF që përqendrohen në zhvillimin e qëndrueshëm, shoqata grash, ose dhe sipërmarrje ekzistuese (psh. kompani që shesin pajisje diellore që mund të bashkësponsorizojnë projektin tuaj). Shpjegoni misionin dhe përparimin tuaj deri tani dhe kërkoni bashkëpunim specifik. Për shembull, bashkia mund të ndihmojë me lejet ose të lejojë përdorimin e ndërtesave/trojeve publike për instalime; një OJF mund të ofrojë trajnime mbi administrimin e kooperativës; një universitet mund të ofrojë studentë vullnetarë ose analizë të të dhënave.

Krijimi i këtyre partneriteteve mund të sjellë ekspertizë dhe besueshmëri. Ai dërgon një sinjal te komuniteti më i gjerë se projekti ka mbështetje të gjerë, ndërsa partneritetet mund të shfrytëzojnë njohuritë dhe burimet e komunitetit energjetik për të themeluar kooperativën. Grafiku vijues përshkruan shembuj të grupeve potenciale të interesit.




Figura 4: Shembull i grupeve të mundshme të interesit në një bashkësi energjie
Burimi: Krijuar nga autorët

3.5 LARMIA DHE PËRFSHIRJA

Garantoni që në krye larmi dhe përfshirje. Ndërsa ngrini ekipin bërthamë dhe grupet e punës, përpikuni që të përfshini njerëz me prejardhje e gjini të ndryshme. Ndonjëherë, pengesat sociale ose zakonet mund të përjashtojnë pa dashje grupe të caktuara (për shembull, shpesh gratë mund të mos ofrohen për detyra teknike).

Për të siguruar larmi dhe përfshirje, mund t'ju ndihmojë struktura e mëposhtme:

1. *Integroni shprehimisht barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në deklaratat tuaja udhëzuese (shiko seksionin 3.3) kur shtjelloni kornizën strategjike.*

2. *Kryeni një **analizë mbi gjininë dhe përfshirjen**, duke e analizuar në tërësi gjendjen me këtë pyetje në mendje: Çfarë mund të pengojë dikë që të marrë pjesë në komunitetin energjetik, dhe si mund të hiqen këto pengesa? Për shembull, nëse takimet përkojnë me kohën kur gratë zakonisht janë të zëna me detyra shtëpiake, shënojeni këtë si pengesë dhe mendoni për zgjidhje të mundshme si përshtatja e orarit. Nëse mungesa e njohurive teknike paraqet një pengesë, një zgjidhje mund të jenë trajnime bazë.*

3. *Përgjigjuni gjetjeve të analizës gjinore me masa të synuara, të formalizuara në një **Plan Veprimi** të thjeshtë, i cili përcakton objektivat, veprimet, afatet kohore, përgjegjësitë dhe indikatorët për ndjekje. Tabela vijuese përshkruan një shembull Plani Veprimi për përfshirjen e një komuniteti energjie.*

Objekti	Veprimi	Përgjegjësi	Afati	Treguesi
Përfaqësim i barabartë gjinor	Përbërje e barabartë gjinore në bord	Kryesuesi i bordit	M1– M3	Përqindja e secilës gjini në bord
Fitimi i njohurive mbi temat gjinore	Partneritet me një organizatë grash	Anëtar i bordit X	M2	Krijimi i partneritetit
Përfshirja e njerëzve nga familjet vulnerabël	Anëtarësi me tarifa të reduktuara për familjet vulnerabël	Anëtar i bordit Y	M4	Përqindja e anëtarëve me tarifa të reduktuara

Tabela 1: Shembull i një Plani Veprimi për të garantuar përfshirje në mënyrë sistematike.
Burimi: krijuar nga autorët

Krijimi i një mjedisi ku të gjithë ndihen të vlerësuar dhe të aftë në mënyrë të barabartë do të ndihmojë komunitetin energjetik të formojë ide më të shumta dhe të forcojë përfshirjen e komunitetit.

Gjatë kësaj faze të hershme, REC-ët mund të fillojnë gjithashtu të shqyrtojnë mundësinë e bashkëpunimit me bashkitë ose organizatat e shërbimeve sociale për të përfshirë komunitetet vulnerabël (shiko seksionin 5 për përfshirjen e komunitetit). Këto bashkëpunime mund të jenë thelbësore për të zhvilluar një kuptim të thellë të varfërisë energjetike në kontekstin lokal dhe se si ndërthuret me dobësi të tjera. Në përfundim, kjo mund të lehtësojë procesin e zhvillimit, së bashku, të zgjidhjeve të efektshme për të gjitha palët, veçanërisht për familjet në nevojë.

Kërkime të mëparshme nga WECF përvijojnë veprime të ndryshme gjinore për komunitetet energjetike (figura 5), të cilat mund t'ju ndihmojnë të gjeni strategji brenda Planit të Veprimit të lartpërmendur. Në përgjithësi, këto strategji çojnë drejt kooperativave të energjisë të drejta në bazë gjinore që:

- Sigurojnë qasje të barabartë për gratë në gjithë zinxhirin e vlerës së energjisë: teknologji, punësim, financim, dividendë.
- Sigurojnë kontroll mbi prodhimin dhe konsumin e energjisë.
- Nxisin fuqizimin dhe udhëheqjen e grave.
- Mbështesin drejtësinë gjinore në politikat dhe sektorin energjetik.

3.6 TEKNOLOGJITË E MUNDSHME

Ky seksion fokusohet në vlerësimin e burimeve dhe teknologjive të energjisë së rinovueshme që disponohen. Vlerësimi se cilat burime në zonën tuaj janë të aksesueshme dhe praktikueshme është një hap i rëndësishëm fillestar. Në Shqipëri, hidrocentralet furnizojnë aktualisht rreth 90% të prodhimit të energjisë elektrike; gjithsesi, mungesa e ujit e shkaktuar nga ndryshimet klimatike thekson nevojën për larmi. Këtu hyjnë në lojë komunitetet e energjisë, të cilat mund të nxisin integrimin e burimeve alternative si dielli dhe era, duke e bërë sistemin energjetik më të qëndrueshëm dhe rezistent.

Shikoni me kujdes kushtet lokale: A është rajoni juaj me diell pjesën më të

madhe të vitit, ose a përfitoni nga erëra të forta dhe të qëndrueshme? Në Shqipëri, shumë zona përfitojnë nga nivele të larta të rrezatimit diellor, gjë që e bën sistemin fotovoltaiik një opsion veçanërisht premtues. Energjia e erës mund të jetë po aq e zbatueshme në zonat bregdetare ose mbi terrene të ngritura ku shpejtësitë e erës janë të qëndrueshme. Për të marrë vendime të informuara, komunitetet e energjisë duhet të bazohen në burime të besueshme të të dhënave, si Global Solar Atlas (shih figura 5), për të vlerësuar rrezatimin diellor dhe prodhimet e mundshme. Identifikimi i burimit më të përshtatshëm është thelbësor për përzgjedhjen e teknologjive që përputhen me potencialin energjetik vendor dhe nevojat e bashkësisë.




Figura 5 Potenciali i energjisë fotovoltaike në Shqipëri
 Shqipëria ka kushte të favorshme për FV dhe merr rrezatim diellor kryesisht midis 1.400 dhe 1.500 kWh/kWp/vit. Kjo do të thotë që një central FV me 10 kWp prodhon deri në 15.000 kWh në vit.

Burimi: globalsolaratlas.info

Panelet diellore mbi çati ose një fermë e vogël diellore janë shpesh zgjedhja më e thjeshtë për komunitetet, pasi teknologjia diellore është modulare dhe me kosto mirëmbajtje të ulët. Turbinat e erës mund të kihen parasysht nëse shpejtësitë e erës janë të mjaftueshme. Kur është e përshtatshme, mund të merren parasysht zgjidhje për ruajtjen e energjisë, si bateritë për të përmirësuar besueshmërinë, veçanërisht në zonat ku komuniteti nuk është vijimisht i lidhur me rrjetin kombëtar. Zgjedhjet teknologjike duhet të mbeten sa më të thjeshta për tu siguruar që banorët lokalë të mund të mësojnë, vënë në punë dhe mirëmbajnë lehtësisht teknologjitë.

Së fundmi, një “burim” shpesh i pavënëre është efikasiteti i energjisë. Energjia më e pastër dhe më e përbalueshme është ajo që nuk përdoret. Si pjesë e vlerësimit të teknologjisë, merrni parasysht zbatimin e masave si izolimi i shtëpive, ndriçimi LED dhe sistemet efikase të ngrohjes. Këto veprime pakësojnë ndjeshëm kërkesën totale për energji dhe janë një fushë ku bashkësitë e energjisë mund të ndërmarrin veprime domethënëse. Nisma për kursimin e energjisë, si izolimi i përmirësuar dhe ngrohja efikase kanë fituar tashmë popullaritet në disa bashki shqiptare, duke shfaqur interes të fortë nga komuniteti për uljen e konsumit. Përfshirja e masave të efikasitetit lejon që sistemi i energjisë së përtëritshme të jetë më i vogël, më i përbalueshëm, dhe përsëri plotësisht në gjendje të përmbushë nevojat lokale.

3.7 ZHVILLIMI I MODELIT DHE PLANIT TË BIZNESIT

Qëndrueshmëria ekonomike është thelbësore si shtylla kurrizore e një bashkësie energjetike; prandaj, thelbësor është zhvillimi i një modeli të qëndrueshëm sipërmarrjeje që përfshin prodhimin e energjisë, shpërndarjen dhe qëndrueshmërinë financiare.

Skicimi i modelit të biznesit mund të bëhet me metodën e “Trekëndëshit Magjik”, që është kompakte dhe e thjeshtë. Ai fokusohet në katër pyetje qendrore:

- *Kush janë klientët?*
- *Çfarë ofron kooperativa?*
- *Si krijohet oferta?*
- *Përse është e qëndrueshme financiarisht?*

Këto pyetje shfaqen në një trekëndësh dhe ndihmojnë në nxitjen e diskutimit mbi tre elementët kryesorë të biznesit:

- *Propozimi i vlerës,*
- *Zinxhiri i vlerës, dhe*
- *Modeli i të ardhurave*

Siç tregohet në Figurën 6, dimensioni qendror i trekëndëshit identifikon klientin e synuar (*kush?*), sepse nevojat e tij përcaktojnë përse dhe si funksionon kooperativa. Dimensioni i dytë (*çfarë?*) fokusohet në produktet dhe shërbimet që kooperativa ofron për klientin. Dimensioni i tretë (*si?*) përshkruan veprimtaritë, burimet dhe proceset që i duhen kooperativës për të funksionuar. Së fundmi, dimensionin e katërt (*vlera?*) shpjegon mekanizmat për qëndrueshmërinë financiare, si struktura e kostos dhe rrjedha e të ardhurave. (Gassman, et al., 2014).




Figura 6: Skicimi i një modeli sipërmarrjeje me Trekëndëshin Magjik
Burimi: Gassman, et al., 2014

Më poshtë mund të shihet një shembull i aplikimit të metodës së trekëndëshit magjik për një bashkësi energjetike. Në këtë shembull, bashkësia energjetike do të pajisë një ent publik, në këtë rast një universitet, me energji elektrike të pastër, të përtëritshme, i mbështetur nga komuniteti i energjisë me një model të shëndetshëm sipërmarrjeje.



Figura 7: Shembull i një modeli sipërmarrjeje për një bashkësi energjie mbështetur në metodën e trekëndëshit magjik

Burimi: Krijuar nga autorët

Kur zhvilloni modelin e biznesit, merrni parasysh analizën PEST (nga seksioni 2) për të parashikuar kriteret e realizueshmërisë dhe për të identifikuar rreziqet e mundshme që mund të ndikojnë në qasjen tuaj. Për më tepër, ndërkohë që projekti bëhet më konkret, duhet të kryhet një studim realizueshmërie (shih seksionin 5 mbi planifikimin teknik). Duke përdorur të dhënat nga ky studim, ekipi kryesor duhet të krijojë një plan biznesi të imtësishëm mbi mënyrën se si komuniteti energjetik do të vërë në punë projektin. Ky plan duhet të përshkruajë modelin e biznesit siç tregohet më sipër, duke përvijuar klientët, strukturën e shërbimit, konfigurimin teknik dhe strategjinë financiare.

Në lidhje me financimin fillestar, planifikoni hollësisht se si mund të sigurohet kapitali (shih seksionin 4 mbi strategjitë e financimit). Konsideratat kryesore përfshijnë përcaktimin e raportit të kontributit financiar të anëtarëve dhe të kredive të marra. Planifikimi financiar duhet të përfshijë projeksione financiare që tregojnë se si të ardhurat ose kursimet do të mbulojnë kostot në 5–10 vitet e ardhshme, duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë. Ky do të jetë gjithashtu çelësi për kërkimin aktiv të financimit nga donatorët, investitorët ose institucionet, duke përdorur planin e biznesit për të krijuar një rast të fortë.

Përveç aspekteve të biznesit, krijoni një plan zbatimi projekti: një afat kohor për veprimet kyçe (porositja e pajisjeve, ndërtimi etj.), përgjegjësitë për secilën detyrë dhe arritjet për të gjurmuar ecurinë. Përsa i përket planifikimit teknik dhe zbatimit të projektit, seksioni 5 ofron udhëzime gjithëpërfshirëse.

3.8 SKICIMI I KOMUNITETIT ENERGJETIK

Vendosni se si do të organizohet dhe financohet komuniteti juaj energjetik.

Modele të ndryshme të qeverisjes lejojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në projektet e energjisë. Në varësi të formës ligjore të zgjedhur, ato mund të ndryshojnë sipas strukturës së qeverisjes, vendimmarrjes dhe përgjegjësi (shih tabelën më poshtë):

STRUKTURË LIGJORE	PËRSHKRIMI
Kooperativat e energjisë	<i>Kjo është forma më e zakonshme dhe më e shpejtë në rritje e komuniteteve të energjisë. Kjo lloj pronësie u volit kryesisht anëtarëve të vet. Është popullore në vende ku përdorimi i energjisë së përtëritshme dhe bashkësitë energjetike janë relativisht të përparura.</i>
Partneritete të kufizuara	<i>Një partneritet mund të lejojë individët të shpërndajnë përgjegjësitë dhe të gjenerojnë fitime nga pjesëmarrja në një komunitet energjie. Qeverisja zakonisht bazohet në vlerën e pjesës së secilit partner, që do të thotë se nuk ofron gjithmonë “një anëtar – një votë”.</i>
Fondacionet dhe trustet e komunitetit	<i>Qëllimi i tyre është të gjenerojnë vlerë shoqërore, zhvillim vendor dhe jo përfitime për anëtarin individual. Fitimet përdoren për komunitetin, edhe kur qytetarët nuk kanë mundësitë që të investojnë në projekte (për kompanitë e të mirës publike).</i>
Shoqatat e banimit	<i>Shoqata jofitimprurëse që mund të ofrojë përfitime për qiramarrësit në banesa sociale, edhe pse mund të mos jenë të përfshirë direkt në vendimmarrje. Këto forma janë të përshtatshme për trajtimin e varfërisë energjetike.</i>
Bizneset jofitimprurëse në pronësi nga konsumatori	<i>Struktura ligjore që përdoren nga komunitete që menaxhojnë rrjete të pavarura energjie. Ideal për rrjete të ngrohjes së komunitetit, të zakonshme në vende si Danimarka.</i>
Partneritete publik-privat	<i>Autoritetet vendore mund të vendosin të hyjnë në marrëveshje me grupet e qytetarëve dhe sipërmarrjet për të siguruar furnizimin me energji dhe përfitime të tjera për komunitetin.</i>

Tabela 2: Forma të ndryshme ligjore si option për Komunitetet e Energjisë.

Burimi: Rescoop.eu

Çdo model është i ndryshëm. Kur i krahasojmë, mund të mendojmë për aspektet e mëposhtme:

- Kush i merr vendimet
- Si përdoren fitimet (nëse ka)
- Kush merret me detyrat dhe përgjegjësitë ditore

Një mënyrë e suksesshme për të organizuar Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme (REC) është krijimi i një kooperative. Ky është një grup ligjor ku çdo anëtar, si një familje ose biznes i vogël, zotëron një pjesë dhe ka një votë në vendimet e rëndësishme. Kooperativat bazohen në drejtësi: çdo person ka një votë, pavarësisht se sa investon. Kjo e bën atë një zgjedhje të mirë nëse dëshironi pjesëmarrje të barabartë për të gjithë, përfshirë gratë dhe grupet e nënpërfaqësuar. Modele të tjera përfshijnë krijimin e një shoqate jofitimprurëse ose një fondi komunitar që administron projektin. Ju mund të bashkëpunoni gjithashtu me komunën lokale ose një kompani private në një partneritet publik-privat.

Më me rëndësi është që të zgjidhni një strukturë që mban kontrollin në duart e komunitetit dhe lejon pjesëmarrje të barabartë për të gjithë, duke pasur njohje ligjore sipas ligjit shqiptar. Prandaj, ka rëndësi që të njihni rregullat dhe ligjet për komunitetet e energjisë së përtëritshme në Shqipëri.

3.9 TË KUPTUARIT E KUADRIT LIGJOR NË SHQIPËRI

Ligji nr. 24/2023 “Për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë” njeh zyrtarisht Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme. Kjo do të thotë që grupi mund të:

- ✓ Prodhon energji (si nga panelet diellore)
- ✓ Përdor energjinë
- ✓ Ruaj energjinë
- ✓ Shesë energji shtesë të prodhuar

Sipas ligjit, qeveria duhet të nxjerrë një Vendim të Këshillit të Ministrave që përcakton gjithashtu se si mund të krijohen dhe organizohen Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme. Por, derisa të jenë miratuar aktet nënligjore për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme, Kooperativat e Energjisë së Përtëritshme mbeten forma e vetme ligjore e mundshme në Shqipëri.

3.10 THEMELIMI I KOOPERATIVËS DHE HARTIMI I STATUTIT

Regjistroni REC-un si një ent ligjor në përputhje me normat ligjore kombëtare.

Ligji nr. 9901/2008 “Për ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare” është ligji kryesor që rregullon të gjitha llojet e kompanive në Shqipëri, duke përfshirë kooperativat si ente ligjore. Kooperativat jobujqësore (psh. energji, konsumatori) shpesh regjistrohen si kompani tregtare me veçoritë e kooperativave.

Për të nisur një kooperativë të energjisë së rinovueshme, kombinimi më i mirë është:

- ✓ ***Regjistrohuni sipas ligjit 9901/2008*** si kompani me rregulla kooperative
- ✓ Sigurohuni që struktura juaj të ndjekë udhëzimet për ***REC sipas ligjit 7/2017***
- ✓ Organizoni të paktën ***7 anëtarë themelues***
- ✓ Pajtohuni mbi kapitalin – minimumi ***100,000 LEK***
- ✓ Deklaroni në statut qëllimin social/komunitar të kooperativës
- ✓ ***Rezervoni emrin*** në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ***përmes QKB /***
Regjistrimit Tregtar
- ✓ Hapni llogari bankare, depozitoni kapitalin dhe merrni një deklaratë bankare
- ✓ Regjistrohuni në ***autoritetin tatimor, të sigurimeve shoqërore dhe në bashki***
- ✓ Kërkoni mbështetje ose ***ndihmesë teknike***

Do t’ju duhet të hartoni një statut ose akt themelimi për kooperativën, që përshkruan si bashkohen anëtarët, si merren vendimet (psh. parimi “një anëtar – një votë”) dhe si ndahen fitimet/kursimet. Statuti duhet gjithashtu të pasqyrojë parimet tuaja për drejtësi gjinore, për shembull, përfshini një klauzolë që angazhohet për mosdiskriminim dhe mundësi të barabarta në postet drejtuese. Konsultohuni me një avokat ose kërkoni këshilla nga organizata si Milieukontakt Albania ose WECF, që kanë përvojë me kooperativat energjetike, për t’u siguruar që përmbushni të gjitha kërkesat ligjore. Pasi të regjistrohet, kooperativa mund të hapë një llogari bankare, të nënshkruajë kontrata (për blerjen e pajisjeve ose lidhjen me rrjetin) dhe të jetë e kualifikuar për disa programe mbështetëse. Ky hap e kthen grupin tuaj komunitar në një entitet zyrtar të njohur nga ligji.

4. STRATEGJITË E FINANCIMIT DHE MBËSHTETJES

Sigurimi i fondeve për themelimin e një komuniteti të energjisë së rinovueshme dhe/ose vënien në jetë të teknologjive të rinovueshme është një nga elementët kyç për çdo bashkësi energjetike. Ky seksion përshkruan se si një komunitet mund të mbledhë fonde fillestare, të shfrytëzojë financimin, të sigurojë pjesëmarrje të përbalueshme dhe të krijojë financim përmes modeleve të të ardhurave. Qëllimi është paraqitja e strategjive të qarta dhe të thjeshta, të shoqëruara me shembuj, që anëtarët e komuniteteve rurale dhe vendore të kuptojnë dhe veprojnë lehtësisht për:

SUBVENCIONE DHE MBËSHTETJE NGA QEVERIA:

Qeveria shqiptare ka programe për të nxitur energjinë e rinovueshme në shkallë të vogël. Për shembull, një skemë e fundit subvencionoi 70% të kostove të instalimit për ngrohësit e ujit me diell për 2,000 familje. Veç kësaj, Bashkia e Tiranës zhvilloi “Fondin e Komunitetit 50/50”, ku qyteti barazonte çdo lek të kontribuar nga qytetarët për përmirësime në lagje, shumë prej të cilave ishin projekte kursimi energjie.

GRANTE NGA BE DHE RAJONI:

Shqipëria, si pjesë e Ballkanit Perëndimor, përfiton nga fondet zhvillimore evropiane. Komunitetet (shpesh përmes bashkive ose OJF-ve) mund të aplikojnë për grante që fokusohen në energjitë e përtëritshme ose zhvillimin rural. Për shembull, Western Balkans Investment Framework (një nismë e përbashkët e BE-së) dha rreth 10.5 milionë dollarë grante për një projekt parku diellor në Belsh. Ngjashëm, programet dhe instrumentet e BE-së shpesh kanë thirrje për projekte energjie të gjelbërta ose komunitare. Bashkëpunimi me autoritetet lokale ose OJF-të për të aplikuar për këto grante mund të sigurojë financim fillestar të konsiderueshëm.

FINANCIMI PËRMES MODELIT KOOPERATIV:

Themelimi i REC si një kooperativë është në vetvete një strategji financimi. Në një kooperativë, çdo anëtar mund të kontribuojë një pjesë të kostos fillestare, dhe këto kontribute së bashku financojnë projektin. Ky është në thelb investim bashkësie. Avantazhi është që pjesa e çdo anëtari mund të jetë relativisht e vogël, por së bashku arrijnë shumën e nevojshme. Pasi kooperativa të jetë formuar dhe të ketë marrë statusin ligjor, mund të ketë akses në banka, pasi ato janë më të gatshme të japin kredi për një ent ligjor me shumë anëtarë sesa për individë.

CROWDFUNDING (FINANCIM NGA PUBLIKU) DHE MBLEDHJA E FONDEVE NGA KOMUNITETI:

Crowdfunding (p.sh. GoFundMe, Indiegogo) është një mjet i fuqishëm për të mbledhur para nga shumë kontribues të vegjël, në vend ose jashtë vendit. Një shembull suksesi është Piskova Solar Farming, një përpjekje kooperative ku 18 bujq dhe një OJF bashkëpunuan për të montuar panele diellore që furnizonin një pompë ujitëse. Ata nisën një fushatë financimi nga publiku duke synuar 8,700 €. Ndonëse arritën vetëm rreth 3,000 €, kjo mjaftoi për të instaluar një sistem më të vogël 3 kWp dhe për të demonstruar konceptin. Këto raste tregojnë që dhe një financim i pjesshëm publik mund të fillojë një projekt. Komunitetet mund të përdorin ngjarje lokale, media sociale dhe rrjetet e diasporës për të mbledhur donacione. Thelbi është që të shpjegohen qartë përfitimet nga projekti (psh. energji më e lirë, pronësi komunitare, ajër më i pastër) për të frymëzuar njerëzit që të kontribuojnë.

BANKA ETIKE DHE KREDI/HUA TË GJELBRA:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka prezantuar në Shqipëri “Green Economy Financing Facility (GEFF)”, që punon përmes bankave lokale për të ofruar kredi për efikasitet energjetik dhe energji të përtëritshme për familje dhe biznese. Këto hua të gjelbra shpesh vijnë me stimuj, psh., huamarrësit mund të marrin deri në 20% të shumës së kredisë si cashback (rikthim shume e shpenzuar) ose grant pas instalimit të pajisjeve të energjisë së rinovueshme. Disa banka shqiptare (si ProCredit, OTP Bank, Intesa Sanpaolo etj.) kanë linja krediti të dedikuara për projekte të gjelbra, që mbështeten nga fonde ndërkombëtare. Shpesh, këto vijnë me norma interesi më të ulëta ose garanci të pjesshme për rrezik.

Ka shumë rëndësi që të mos shikoni vetëm një burim financimi, por të ndërthurni burimet si një nxitje qeveritare, një grant BE-je ose OJF-je atje, shtoj financim nga publiku dhe kontribut nga anëtarët e komunitetit energjetik për të grumbulluar kapitalin financiar të nevojshëm për ta vënë atë në punë.

Modeli i të ardhurave: Pasi REC të funksionojë, është e rëndësishme të keni një plan të qartë për mënyrën se si do të gjenerojë të ardhura ose kursime dhe do të qëndrojë financiarisht i shëndetshëm me kalimin e kohës (shihni seksionin 3.7 për mënyrën e krijimit të një modeli të qëndrueshëm biznesi). Burimet e përsëritura financiare janë element kyç për të mbajtur në funksion projekte ekzistuese (psh., zëvendësimi i pajisjeve) dhe për financimin e projekteve të ardhshme për zgjerimin e komunitetit energjetik.

Subvencione dhe mbështetje nga qeveria	Lloji /Emri i fondit	Fusha e aplikimit	Numri i përfituesve të mëparshëm	Disponueshmëria	Kombëtar / Lokal
Agjencia Kombëtare e Efiçencës së Energjisë	70% subvencion i kostove të instalimit	Ngrohës uji me diell	2,000 familje	2024/2025	Kombëtar
Bashkia Tiranë	Fondi i komunitetit 50/50	Përmirësime në lagje dhe projekte kursimi energjie	103 familje dhe 120 projekte	Çdo vit	Lokal

Tabela 3: Vështirim i përgjithshëm të subvencioneve/mbështetjes së qeverisë shqiptare
Burimi: Krijuar nga autorët

Donatorë Ndërkombëtarë	Lloji /Emri i fondit	Fusha e aplikimit	Numri i përfituesve të mëparshëm	Disponueshmëria	Kombëtar / Lokal
Green Economy Financing Facility në Shqipëri	Deri në 20% subvencion	Pajisje kursimi energjie	E hapur për të gjithë	Çdo vit	Kombëtar
Bashkimi Evropian dhe grante rajonale	80-100% subvencion	Grante për energji të rinovueshme ose zhvillim rural	E hapur për sektorin privat dhe OJF	Çdo vit	Kombëtar
Crowdfunding dhe mbledhje fondesh komunitare	GoFundMe, Indiegogo, etj.	Nevojat e komunitetit	E hapur për të gjithë	Çdo vit	Kombëtar

Tabela 4: Mundësitë e financimit për komunitetet e energjisë në Shqipëri dhe nga donatorët ndërkombëtarë
Burimi: Krijuar nga autorët

5. PLANIFIKIMI TEKNIK DHE ZBATIMI

Krijimi i infrastrukturës fizike për një komunitet energjetik në Shqipëri kërkon planifikim të kujdesshëm, ndërtim kapacitetesh gjithëpërfshirëse dhe orientim në proceset administrative. Panelet diellore (FV) ofrojnë një pikë hyrjeje të fuqishme: janë relativisht të lehta për t'u instaluar, të ndryshueshme në përmasa sipas komuniteteve dhe përshtaten mirë me potencialin diellor të Shqipërisë. Me rritjen e përvojës dhe besimit, komunitetet energjetike mund të zgjerohen drejt teknologjive më të mëdha si sistemet e energjisë së erës.

Zgjedhja e vendit dhe projektimi i prodhimit të energjisë

Identifikoni një vend duke u mbështetur në potencialin e gjenerimit të energjisë, kërkesën e komunitetit për energji dhe realizueshmërinë teknike.




Figura 8: Tre kriteret më të rëndësishme për përzgjedhjen e vendit të prodhimit.

Burimi: Krijuar nga autorët

Për sistemet FV, çatitë (sidomos të ndërtesave publike) ose tokat e papërdorura janë ideale. Vlerësimi i afërsisë me rrjetin dhe i të drejtave mbi pronën duhet të kryhet që në fazën e hershme për të siguruar realizueshmërinë. Ligji nr. 24/2023 “Për promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë” garanton akses të sigurt në rrjet për prodhuesit e energjisë së rinovueshme, ndonëse ata duhet të përmbushin kërkesa teknike specifike. Projektet e energjisë së rinovueshme me

kapacitet nën 500 kW përfitojnë nga disa përjashtime krahasuar me projektet e mëdha. Megjithatë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) duhet t'i jepet informacion që në fillim; më shumë hollësi gjenden në "Lidhja me Rrjetin dhe Shpërndarja e Energjisë".

Para se të investoni para' ose të instaloni pajisje, vlerësoni parametrat teknike dhe ekonomike përmes një studimi realizueshmërie, mbi të cilin ndërtoni modelin dhe planin e biznesit (shih seksionin 3.7). Ky nuk ka nevojë të jetë një raport shumë teknik; mund të jetë një listë kontrolli ose një anketë e vogël, ndoshta me ndihmën e një eksperti ose OJF-je. Aspektet kyçe për tu vlerësuar përfshijnë:

- **VLERËSIMI I BURIMEVE:** Konfirmoni disponueshmërinë e burimit të zgjedhur energjetik (p.sh. a ka hije që ndikon në numrin e orëve të diellit? Çfarë të dhënash ka në zonën tuaj për shpejtësinë e erës – ekzistojnë të dhëna nga Shërbimi Meteorologjik Shqiptar ose studime ekzistuese?).
- **NEVOJAT PËR ENERGJI DHE KËRKESAT E TREGUT:** Përgjigjuni pyetjeve kyçe për përmasat e projektit: Sa energji nevojitet? Sa mund të prodhohet? Si mund të përputhet prodhimi me kërkesën? Energjia e tepërt duhet të ruhet (bateri) apo të dërgohet në rrjet?
- **ZGJIDHJA TEKNIKE:** Vendosni për madhësinë dhe projektin e sistemit. Për shembull, nëse zgjidhet diellorë, përcaktoni përafërsisht numrin e paneleve dhe baterive (nëse ka) që nevojiten për të plotësuar kërkesën. Nëse lidheni me rrjetin kombëtar (për të shitur energji të tepërt ose net-metering), identifikoni kërkesat teknike si matës dykahësor.
- **ANALIZA DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR:** Vlerësoni koston tërësore të projektit dhe kostot vijuese operative. Pastaj, përcaktoni si do të financohet (nga kontributet e komunitetit, kredi, grante etj.) dhe nëse, me kalimin e kohës, kursimet ose të ardhurat e pritshme i mbulojnë këto kosto.
- **RISHIKIMI RREGULLATOR DHE LIGJOR:** Verifikoni çfarë lejesh ose miratimesh kërkohen. Hulumtoni rregulloret shqiptare mbi instalimet e energjisë së përtëritshme dhe kooperativat. Për shembull, mund të nevojitet leje për të instaluar një park diellor të një madhësie të caktuar. Studimi i realizueshmërisë duhet të sqarojë nëse ka pengesa ligjore për projektin. Ligji shqiptar për energjinë e rinovueshme u lejon komuniteteve që të prodhojnë dhe madje të shesin energji të rinovueshme, por mund të kërkohet të ndiqen procedura për lidhjen me rrjetin (shih seksionin "Lidhja me Rrjetin dhe Shpërndarja e Energjisë").

- **NDIKIMI SOCIAL DHE KONSIDERATAT GJINORE:** Vlerësoni se si projekti do të ndikojë mbi komunitetin nga pikëpamja shoqërore. A do të krijojë vende pune ose kërkohet trajnim? A ka konflikte të mundshme (psh., mbi çatinë e kujt do montohen fillimisht panelet, ose çështje përdorimi tokash)? Sigurohuni që përfitimet (si ulja e faturave të energjisë ose të ardhurat nga shitja e energjisë) të ndahen në mënyrë të drejtë.

Dokumentoni gjetjet e studimit të realizueshmërisë në një raport të thjeshtë. Nëse studimi zbulon sfida (psh., hije që ndikonë në prodhimin e energjisë diellore), përdorini këto gjetje për të ndrequr planin dhe mos i trajtoni si pengesa. Ky hap ka të bëjë me identifikimin e kërkesave praktike dhe sigurinë që projekti është i realizueshëm para se të vijohet më tej.

PROKURIMI DHE INSTALIMI

Përdorni procese prokurimi të hapura dhe transparente për të zgjedhur furnizuesit dhe kontraktuesit. Mundohuni të merrni disa oferta nga kompani të ndryshme instalimi, krahasojini këto oferta dhe kërkoni projekte reference. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit brenda komunitetit dhe siguron vlerë për paratë. Pajisjet duhet të përmbushin standardet e sigurisë, dhe preferencë në Shqipëri duhet t'i jepet teknologjive me shërbim të besueshëm pas shitjes.

TRAJNIMI TEKNIK DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Për të siguruar qëndrueshmërinë, që në fillim përfshini anëtarët e komunitetit në role teknike. Ofroni trajnim për vënien në punë, mirëmbajtjen dhe monitorimin e sistemeve, veçanërisht duke synuar të rinjtë, gratë dhe grupet e skajmuara. Bashkëpunimet me shkolla profesionale ose OJF-të janë të dobishme për mbështetjen në trajnimet teknike. Kjo ndërton pronësi lokale dhe ndihmon për të ruajtur aftësitë brenda komunitetit.

LIDHJA ME RRJETIN DHE SHPËRNDARJA E ENERGJISË

Lidhja me rrjetin mbetet një sfidë në Shqipëri për shkak të procedurave të paqarta dhe vonesave. Komunitetet energjetike duhet të bashkërendohen me OSHEE-në, duke siguruar që të gjitha dokumentet të jenë të sakta dhe afatet të mbikëqyren. Kur planifikoni vendin e prodhimit, para se të kontaktoni OSHEE-në, duhet të sigurohet së paku dokumentacioni vijues:

- Përshkrimi i projektit me parametrat teknikë
- Propozimi për pikën e lidhjes së impiantit me rrjetin

Në rastin më të mirë, ndër anëtarët e komunitetit energjetik ka inxhinierë lokalë që veprojnë si pika kontakti për OSHEE-në, ose angazhohen partnerë teknikë për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret dhe standardet teknike shqiptare.

Shpërndarja e energjisë varet nga kërkesa për energji e vendit të zgjedhur (psh., Marrëveshje për Blerje Energjie me një institucion publik ndërkohë që në pronën/çatinë e tyre instalohen panelet FV) dhe administrimi i energjisë së tepërt. ***Ndaj, para fillimit të instalimit, duhet sqaruar me OSHEE-në dhe Entin Rregullator të Energjisë (ERE) se si mund të shpërndahet dhe të kompensohet energjia elektrike.***

6. ANGAZHIMI I KOMUNITETIT DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Angazhimi aktiv i komunitetit, fuqizimi i vendasve dhe sigurimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse janë parakushte për suksesin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme (REC) në Shqipëri. Një përfshirje e fortë e bashkësisë nxit pronësinë, qëndrueshmërinë dhe përfitimet ekonomike, sidomos kur gratë, të rinjtë dhe grupet e skajmuara angazhohen aktivisht. Ky seksion përshkruan hapat kryesore për promovimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe forcimin e kapacitetit komunitar.

FUSHATA NDËRGJEGJËSIMI

Filloni duke organizuar workshope, seminare dhe sesione informimi në komunitetin tuaj për të shpjeguar se çfarë janë komunitetet e energjisë së përtëritshme dhe pse kanë rëndësi. Përdorni gjuhë të qartë, lokale dhe shembuj konkretë për familjet dhe sipërmarrjet shqiptare. Theksoni përfitimet nga energjia e rinovueshme, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit, kursimet në kosto dhe pavarësinë energjetike. Sigurohuni që të trajtoni drejtësinë gjinore, duke përdorur një strategji komunikimi me perspektivë gjinore (psh., me modele femërore). Bashkëpunimi me OJF lokale dhe bashkitë mund të ndihmojë në arritjen e një audience më të gjerë.

Më tej, përfshini gjithashtu grupe të dobëta nga ana sociale dhe ekonomike, duke synuar:

- Të moshuarit dhe pensionistët
- Personat me aftësi të kufizuara
- Personat me probleme shëndetësore afatgjata
- Gratë, sidomos ato të veja ose të vetme
- Familjet me një prind
- Grupe refugjatësh dhe emigrantësh, që mund të përballen me sfida gjuhësore
- Personat në banesa me qira
- Të rinjtë, studentë ose jo përfitues të ndihmave sociale

INCENTIVAT PËR PJESËMARRJE

Për të arritur një bazë solide anëtarësie, duhet të ketë stimuj në strategjinë e rekrutimit. Përfitimet financiare mund të jenë ulje të kostove të energjisë ose qasje në pajisje më të lira (si module FV, sisteme baterish) përmes porosive në grup që komuniteti energjetik i bën për anëtarët e vet. Incentiva jofinanciare mund të jenë krijimi i vendeve të punës në bashkësi, certifikime aftësie nga programet trajnuese ose njohje përmes çmimeve komunitare. Komunikimi transparent për këto përfitime do të motivojë më shumë njerëz që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë aktivisht.

Veç këtyre, edhe tarifat e anëtarësisë ndikojnë në përfshirjen sociale. Strategjitë vijuese sigurojnë që anëtarësimi dhe pjesëmarrja të jenë të përballueshme:

- *Tarifa të ulëta pjesëmarrjeje: Mbani koston e anëtarësimit sa më të ulët që të jetë e mundur.*
- *Politika gjithëpërfshirëse për anëtarët e cënueshëm: Kooperativa mund të vendosë që një numër i caktuar anëtarësimesh ose një sasi bazë energjie të ofrohet me çmim të ulur ose të subvencionuar për familjet që marrin ndihmë sociale ose me të ardhura shumë të ulëta. Tjetër model është që familjet që nuk mund të paguajnë në para' mund të kontribuojnë me punë, duke ndihmuar në instalim, mirëmbajtje ose detyra administrative në vend të tarifave.*

NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR GRATË DHE GRUPET E SKAJMUARA

Njohuritë dhe aftësitë nxisin rritjen. Hartoni programe trajnimi të fokusuara në administrimin e energjisë, udhëheqësinë dhe sipërmarrjen, të skicuara posaçërisht

për gratë, të rinjtë dhe grupet e skajmuara në bashkësi. Këto kurse duhet t'i pajisin pjesëmarrësit me njohuri teknike për të vënë në punë sistemet e energjisë së përtëritshme, për të administruar projekte në bashkësi dhe për të krijuar mundësi të ardhshme për sipërmarrje (për shembull, përmes skicimit të modeleve të sipërmarrjes me Metodën e Trekëndëshit Magjik).

Duke u fokusuar te ndërgjegjësimi, përfshirja, incentivat dhe edukimi, komuniteti juaj i energjisë në Shqipëri do të jetë në rrugën e lulëzimit. Ngritja e kapaciteteve në nivelin vendor garanton që të gjitha zërat dëgjohen dhe që përfitimet ndahen barabar, duke e shndërruar projektin e energjisë komunitare jo vetëm sukses mjedisor por dhe shoqëror.

7. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE ZGJERIMI

Për të siguruar që komunitetet e energjisë së rinovueshme në Shqipëri të arrijnë sukses të qëndrueshëm dhe të promovojnë drejtësinë gjinore, është thelbësore që të krijohen sisteme të forta për monitorimin, vlerësimin dhe zgjerimin e ndikimit të tyre. Ky proces ndihmon në gjurmimin e përparimit, identifikimin e sfidave dhe mbështetjen e rritjes së komuniteteve të reja energjetike.

HARTIMI I INDIKATORËVE TË MONITORIMIT

Filloni duke përcaktuar tregues të thjeshtë dhe të qartë për të matur performancën e komunitetit. Fushat kryesore përfshijnë:

- Sasia e energjisë së rinovueshme të prodhuar dhe të përdorur
- Qëndrueshmëria financiare (mbulimi i të ardhurave dhe i kostove të projektit)
- Përfitimet për komunitetin (si krijimi i vendeve të punës, trajnime)
- Barazia gjinore (sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave)
- Mblidhni rregullisht të dhëna për të kuptuar se sa mirë po arrin komuniteti të realizojë qëllimet e tij.

VLERËSIME DHE PËRSHTATJE TË RREGULLTA

Kryeni vlerësime periodike, psh., çdo gjashtë muaj ose çdo vit për të shqyrtuar përparimin në komunitet. Përdorini këto vlerësime për të diskutuar se çfarë ecën mirë dhe çfarë sfidash ekzistojnë. Përfshini të gjithë anëtarët, veçanërisht gratë dhe grupet e skajmuara për të marrë perspektiva të ndryshme. Bëhuni gati të rregulloni planet, të përmirësoni menaxhimin ose të futni aktivitete të reja bazuar në reagimet dhe në rezultatet e përftuara.

ZGJERIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Sukseset në komunitetin tuaj energjetik mund të jenë burim frymëzimi për të tjerët. Duke dokumentuar praktikat më të mira, sfidat dhe zgjidhjet në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme, krijoni burime të vlefshme për riprodhim. Shpërndani këto histori me komunitetet fqinje, autoritetet vendore dhe aktorët përmes prezantimeve, raporteve ose mediave sociale. Ky shkëmbim njohurish ndihmon në riprodhimin e modeleve të efektshme në rajone të ndryshme të Shqipërisë, duke përshpejtuar kalimin drejt energjisë së pastër dhe gjithëpërfshirëse.

RRJETËZIMI DHE SHKËMBIMI NDËRKOMBËTAR

Angazhohuni me rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare të komuniteteve energjetike. Platforma si REScoop.eu dhe organizma të ngjashme ofrojnë mundësi për njohuri nga vendet ku komunitetet e energjisë së përtëritshme janë të konsoliduara dhe u lejojnë komuniteteve shqiptare që të adoptojnë strategji të provuara, të arrijnë mbështetje teknike dhe të bëhen të dukshme. Këto lidhje fuqizojnë përpjekjet lokale dhe kontribuojnë në një lëvizje më të gjerë drejt sistemeve energjetike të qëndrueshme dhe me drejtësi gjinore.

Duke vendosur korniza të forta për monitorim dhe vlerësim dhe duke ndarë gjerësisht sukseset, komuniteti juaj energjetik mund të ngrejë themele të forta për rritje. Kjo siguron që projektet e energjisë jo vetëm të japin energji të pastër, por edhe të promovojnë përfshirjen sociale dhe të bëhen shembull për të tjerët në gjithë Shqipërinë.

